REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr.Br. 01/584
Më/Dana 14.06.2022
NOVOBËRDË NOVO BRDO

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj._____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e tretë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **17.06.2022** (e premte) duke filluar në orën **10:00.**

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth gjendjes se ambientit në teritorin e Komunës;
3. Njoftim nga zyra për Komunitete dhe Kthim rreth aktiviteteve të fundit;
4. Të ndryshme;

Me: 13.06.2022
Në: Novobërdë

Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit për Komunitete
Sh.Mustafa

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
GALËSE - IZLAŽNA
Nr/Br 01/585
Me/Dana 14.06.2022.
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Komunitete e mbajtur me: 17.05.2022, duke filluar nga ora 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për Komunitete Shqipe Mustafa, antarët e komitetit: Dobrivoje Đorđević, Violeta Milošević, Vlora Vllasaliu, Edison Jashari, Selatin Nuhiu, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, Drejtori i Shendetësisë zt.Goran Simijonovic, zyrtari për kthim Marko Markovic, zv.kryesuesi Ramush Mehmeti dhe përfaqësuesi i OSCE-a.

Kryesuesja e Komitetit Shqipe Mustafa pasi pershendeti të pranishmit konstatoj korumin, prezent janë 6 antarë të komitetit për komunitete dhe filloj mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raportim dhe diskutim rreth gjendjes në ambulantat e Komunës;
3. Diskutim rreth procedurave për fillimin e hartimit të buxhetit për vitin 2023;
4. Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim rreth aktiviteteve të fundit;
5. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a pajtohen me këtë rend dite?
Pasi nuk pati propozime njëzëri u aprovua rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.
Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.
Pika e dytë: Raportim dhe diskutim rreth gjendjes në ambulantat e Komunës;
Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalen Drejtorit të shendetësisë zt.Goran Simijonovic.
Goran Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: që nga momenti që kam marrë poziten e Drejtorit të Shëndetësisë kam pasur takim e Drejtorin e QKMF-së dhe me stafin tjter të QKMF-së
Ku kemi diskutuar rreth problemeve të nevojave të kësaj qendre. Në këtë takim që kemi pasur me Drejtorin, motrat dhe udhëheqësit e kësaj qendre ato i kanë paraqitur nevojat dhe kërkesat për punë të mëtutjeshme të kësaj qendre dhe të gjithë ambulantat kanë konstatura se kushtet në ambulanta janë shumë të rënda dhe të vështërsuara që ne të mundë të ju ofrojm qytetarëve ndihmë të nevojshme. Vërejtjet kryesore kanë qenë se ka munguar materiali i nevojshem medicional, nuk ka pasur nxemje, kanë munguar mjete tjera të punës që ne të mundë të ju ofrojm qytetarëve ndihmë dhe sherbime. Gjithashtu ka pasur vërejtje edhe për mjetin e autoambulanec i cili në atë kohë ka qenë i dëmtuar dhe jasht perdorimit. Me 14 shkurt unë i kam vizituar një pjesë të autoambulantave dhe kam konstatuar se më të vërtet kanë kushte të rënda të punës. Gjatë këtyre takimeve që unë kam pasur në këto shtepi

shendeti unë kam mbajtur shenime se cka saktesishtë ju mungon dhe kam bërë listen e prioriteteve që do të duhet sa më shpejt që të intervenojmë në mënyrë që të kenë kushte të punës. E permenda edhe më herët se edhe auto ambulanca ka qenë jashtë perdorimit mirëpo e kemi aftësuar për punë dhe tani janë duke e shfytëzuar në mënyrë që tju dalin në ndihmë qytetarëve. Sa i perket problemeve infrastrukturale i plotësojnë kushtet për funksionim normal, mirëpo ne do të vazhdojm punen edhe në përiudhen e ardhshme në mnëyrë që të funksionojn më mirë, ju falminderit.
Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.
Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: e falenderoj Drejtorin per këtë raport pasi që raporti ishte shumë i mirë dhe i sakt se si qendron gjendja në ambulanta në teritorin e Komunës sonë. Ambulantave në Komunën e Novobërdës i mungon një autoambulant që duhet të jëtë gjatë gjithë kohës funksionale pasi që e diem se ajo autoambullant është e zhvlersuar, ne mendojm se duhet ta blem një ambulant të re që duhet të jetë në sherbim të qytetarëve dhe është shumë e nevojshme për Komunën tonë pasi që është qender rurale dhe mendoj se kjo duhet të jetë njëher prioritet. Ndërsa gjendja e objekteve nuk është e keqe dhe mendoj se Drejtori ka mendu edhe në fshatin Llabjan të ndertohen një garazh për pelet të nxëmjes qendrore. Gjithashtu në QKMF Novobërdë nuk ka material për kryerje të analizave, besoj se tash e tutje do të jetë e furnizuar gjatë gjithë kohes me material.
Edison Jashari pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se duhet të mendoni edhe për dy probleme që janë esenciale për qytetarët e Komunës: e para është se nuk kemi barantore në afërsi të Komunës, e dyta është se ambulantat funksionojn prej ores 08:00-16:00 dhe pas ores 16:00 nuk kemi sherbim medicional, qytetarët që kanë transport të vetin munden të shkojn në qytete që e rrethojnë Komunën tonë, ndërsa qytetarët që nuk kanë mjete transporti si dhe e dimi se në Komunën tonë nuk ka transport publik ata nuk kanë mundësi që të shkojnë, prandaj të mendohet që edhe në këtë drejtim të bëhet ndonjë zgjedhje, andaj ju lus ju si Drejtor i ri që jeni të mendoni në këtë drejtim, ju faleminderit.
Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: ju falenderoj shumë pasi që jeni duke diskutuar për një pikë shumë të rëndësishme, e falenderoj shumë edhe Drejtorin për raportin e dhënë para këtij komiteti, natyrisht që do të mbetet edhe obligim i imi dhe i Drejtorit që ne si ekzekutiv të diskutojmë më seriozisht për këtë qështje dhe të gjejmë zgjidhje për problemet të cilat u ceken. Natyrisht se qështja e shendetetit është shumë e rëndësishme për të gjithë ne dhe duhet të krijojm kushte të mjaftueshme për ambulantat tona. Ambulantat furnizohen me material esencial edhe nga Ministria e Shendetësisë por furnizohen edhe nga Komuna, atë që e kemi ne obligim si Komunë është se ne duhet ti përmbushim të gjitha kërkesat e tyre. Edhe qështja e autoambulantes që u përmend këtu është shumë me rëndësi dhe të gjithë e diem se në qfarë gjendje është dhe është shumë e nevojshme që të kemi një autoambulanc të re dhe natyrisht që është pak e kushtueshme, por duhet shikuar mundësit financiare edhe prej Komunës por edhe përmes donacioneve të ardhshme. Prandaj në ditëtë në vazhdim po na mbetet që diskutimet që i bëmë këtu ti zbatojmë dhe në raportimet e ardhshme të raportohet për një gjendje më të mirë, pra unë dhe Drejtori do të bisedojm më Kryetarin në mënyrë që të bëjm një zgjidhje më të mirë, për më bë zgjidhje që autoambulanca të funksionojnë 24h nuk është aq e lehtë por të pakten me bë një zgjidhje deri në ora 24:00 kishte qenë e mjaftueshme të pakten në dy ambulanta. Unë po du me ju njoftu edhe për një veprim që e ka bërë një banorë i Gjilanit, Ramiz Berisha javen e kaluar javen e klauar ka shpernda 3 karroca për invalida dhe ai ka shpreh gadishmerin që të sjell ende nese ka nevoj si dhe ka premtuar se do të sjell edhe shtreter, gjithashtu kërkes e stafit të QKMF-së ka qenë edhe autoambulanca dhe ai nuk ka premtuar se do ta siguroj shpejt dhe e ka marrë për obligim se do ta gjej ndonjë mundësi, unë e falenderj shumë në emër të juajin dhe të ambulancave, sic e than edhe ata ka nevoj për ato pasi që ka persona që vini dhe nuk kan mundësi të ecin, ju faleminderit.
Goran Simijonovic tha: në mënyrë gjenerale kur e permenda investime për objekte si për barna ashtu edhe për renovim të objekteve e mendova edhe këtë sigurimin e një automjete për transport të pacienteve sipas nevojes dhe jemi në diskutime me donatar dhe nuk dua tash të jep detaje por në

momentin që do të kryhet nga donatroët do të jeni të informuar. Sic e permendi edhe Bajrush Ymeri është mirë që të kyceni të gjithë ata që deshirojnë të na ndihmojn pasi që ju e dini gjendjen në Komunën tonë, pasi që e dini edhe gjendja finanicare nuk është shumë e volitshme dhe është vështir të mbulojm shifra të mëdhaja, mirëpo do të punojmë në atë drejtim në mënyrë që ti realizojmë. Besoj se në raportimet e ardhshme do të raportojm dhe pergjigjemi më pozitivishtë, sa i perket qështjes së peletit e di se në shumë ambulanta e kanë problemin e njejt e jo vetem në fshatin Llabjan por ne e kemi pregaditur një planë të punës në mënyrë që ta zgjedhim në vitin e ardhshëm pasi që nuk është shumë e madhe e mjeteve që duhet të investohet, ndërsa sa i perket materialit për analiza është në proces e siper furnizimi me materiale për ambulanta dhe shumë shpejt do ti kenë të gjitha materialet e punës për kryerjen e sherbimeve. Sa i perket qështjes për munges të barnatoreve dhe stafit i cili nuk punon pas ores 16:00 jemi në diskutim me të gjithë stafin sic e permendi edhe zt.Bajrush Ymeri pasi që është problem shumë i madhë, por jemi në pregaditje të planit dhe i them Bajrush Ymerit se nese vazhdojm kështu sic e kemi filluar do të arrijm rezultate pozitive.
Dobrivoje Djordjevic tha: gjatë këtij raportimi ju nuk e permendet se sa mjek punojnë në sektorin e Drejtorisë së Shendetësisë?, sa motra medicionale?, sa punëtorë punojnë në ambulanta?, të cilët financohen nga buxheti i Ministrisë së Shendetësisë, pastaj mos ti perziem edhe mjeket që paguhen nga buxheti i Republikes së Serbisë, mos të ndodhë që mjeket të grumbullohen në nje ambulant e të rrin e pastaj pasdite të mos kemi funksionim të ambullantave. Pse mos ti ndajm p.sh në kufc janë 20 motra mediocionale që vetem rrin prej ore 09:00 - 14:00, pse mos ti ndajm këto të punojnë në dy ndrrime?. Sa i perket kësaj nese do të mundë të arrini që ta realizoni do të jetë sukses i madhë i juaji.
Goran Simijonovic tha: sa i perket QKMF- së ku janë të përfshirë të gjitha ambulantat i kemi 43 punëtorë, nga këta janë 3 mjek ku 1 mjek specialist i mjekësisë familjare Dr. Rrahimi ku njëkohësishtë është edhe Drejtor i QKMF-së , 1 mjeke dhe 1 stomatologe është shumë e vërtet se me 3 mjek ne nuk mund ti mbulojm nevojat e të gjithë qytetarëve ndërsa numri i stafit të motrave i bie që të jetë 40. Ne jemi duke punuar e kemi bërë një planë të punës që së paku deri në ora 21:00 të kemi motra që kujdestarojnë në ambulanta, jemi duke punuar në këtë drejtim.
Dobrivoje Djordjevic tha: mos të hyjë në polemik por po më intereson të dij Dr. Violeta sa kontrolla i ka bërë gratis, unë mundë të them se fleta e bardhë mundë të bëj gjithqka mundë të shkruaj, Drejtori u pergjegj në bazë të raporteve.
Bajrush Ymeri tha: në punëtorët shendetësor nuk kemi vërejtje, ata punën e bëjnë mirë, kur qytetarët janë të shendosh ata kanë punë më pak dhe lusim Zotin të kemi sa më pak të sëmurë, mirëpo ju mungojnë mjetet është normale pasi që deri më tani nuk kemi pasur asnjë ankesë në stafin mjeksorë dhe kjo fush kërkon angazhim në mënyrë që të permirësohet gjendja. Më vjen mirë që për herë të parë po degjëoj këtë lloj debati në këtë komitet që është në nivel më të ulët se Kuvendi, është interes i të gjithëve që gjendja shendetësore të jetë e mirë dhe mendoj se ka mundësi me u bë, vetem se kerkon vullnet politik. Një kërkes që kam për Drejtorin është se qytetarët kanë bërë kërkes për ndihmë për kontrollat e tyre që ju kanë kushtuar pak dhe ende nuk ju janë realizuar kërkesat e tyre dhe është mirë me ju kthy një pergjigjje qytetarëve qoft pozitive apo negative pasi që je i obliguar që brenda 30 ditëve të ju pergjigjesh.
Goran Simijonovic tha: e dini sa i perket këtyre ndihmave kemi pasur një bllokat nga vet Kuvendi ku ka kërkuar që të mos ipet kjo lloj ndihme, sinqerisht të them se në Drejtorin e Shendetësisë nuk kam pranuar asnjë kërkes për ndihmë financiare përveq 1 kërkese që ka ardhur gjysmë ore para mbledhjes.
Selatin Nuhiu tha: mendoj se kjo pikë të mos diskutohet edhe këtu por të shkoj edhe në Kuvend pasi që është pikë në interes të qytetarëve.
Kryesuesja tha: e falenderoj Drejtorin e shendetësisë për një plan të shkelqyer që e keni parapa dhe po shpresoj se më shumë punë do të realizohet, falenderoj antarët e komitetit që kanë ndarë të gjitha nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, faleminderit zt.Nënkryetar që keni ndarë vullnetin me na ndihmu

dhe përkrahë dhe keni biseduar edhe më Kryetarin gjithashtu Ramiz Berisha falenderoje nga ne, i'u jemi mirënjohës.
Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja e hudhi në votim propozimin e Selatin Nuhiu.
Pas konstatimit të 6 anëtarve prezent, 5 votuan për dhe 1 kunder (Dobrivoje Djordjevic) aprovohet propozimi që kjo pikë të shkoj në KPF dhe Kuvend.
Pika e tretë: Diskutim rreth procedurave për fillimin e hartimit të buxhetit për vitin 2023;
Kryesuesja tha: për këtë pikë nuk është askush që të prezantoj pasi që ende nuk ju ka arritur Qarkorja buxhetore Drejtoris së Financave.
Pika e pestë: Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim rreth aktiviteteve të fundit;
Kryesuesja për këtë pikë ja kaloj fjalen zyrtarit për kthim Marko Markovic.
Marko Markovic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që shefja e zyres është në pushim mjeksorë, këto informata që do ti paraqes janë nga parqitja jonë e fundit në këtë komitete e deri më sot. Sa i perket kthimit dhe kthimit të qëndrueshëm jemi duke punuar në projektin DRK5 ku të gjitha dokumentacionet janë të kompetuara dhe nënshkruara për 6 shtëpi të cilat do të ndertohen dhe renovohen, ingjineret kanë qenë në terren dhe e kanë parë gjendjen, janë pajtuar se gjithqka është në rregull dhe mundë të fillojn projektin. Sa i perket këtij projekti familjet perfituese që do tju ndertohen shtepitë do të marrin ndihmë pas përfundimit të këtyre shtepive edhe në material higjenik dhe mjete të punës për kthim të qëndrueshëm në mënyrë që të fillojnë ndonjë biznes, afati për përfundimin e këtij projekti është 31 gushtë. Të gjitha familjet që kanë aplikuar për kthim dhe kanë fëmijë nën moshen 2 vjecare ne e kemi pregaditur një projekt dhe e kemi derguar në Bonstill dhe ata do tju sigurojnë artikuj ushqimor për atë moshë. Sa i perket këtij projekti do të kemi një trajnim ku tema do të jetë zhvillimi ekonomik dhe do të jenë pjesëmarrëse femrat e 6 familjeve të kthyere si dhe do të jenë edhe 3 përfaqësuese nga komuniteti shqiptarë. Ne kemi takime të shpeshta me UNHACER-in dhe partneret e tyre rreth procesit të kthimit spontan si dhe pregaditjen e planit të vizitave, kaq nga unë nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.
Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.
Bajrush Ymeri tha: faleminderit Marko për raportimin natyrisht e di se e keni prioritet që ti ndihmoni përsonat e kthyer dhe të zhvendosur por kerkoj që të keni mirëkuptim edhe për ndonjë rast nga komuniteti shqiptarë dhe nga komuniteti rom gjithashtu që janë në gjendje të vështir ekonomike.
Marko Markovic tha: e ceka edhe në fillim se unë jam zyrtar për kthim e kemi edhe zyrtarin për komunitete ai gjatë periudhes së fundit ka qenë në pushim, cdo kërkesë që ne e kemi marrë nga komuniteti shqiptarë unë e kam derguar në Ministri.
Pika e katërt: të ndryshme.
Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.
Edison Jashari tha: në fshatin Bostan ne si komunitete rom dhe serb e kemi një problem janë qenët e pastreh ku janë më shumë se ne banorët rreth 50 qenë dhe kemi pasur 3 raste kur qenët kan sulmuar qytetarët, këto raste i kemi paraqitur edhe në polici por nuk kanë marrë asnjë masë andaj e lus Komunën të ndermerr dicka .
Dobrivoje Djordjevic tha: e kam një pyetje për OSBE-n që është prezent pasi që ata i mbrojn kafshët andaj të na tregojnë se si mendojnë të na mbrojne neve?.
Marko Markovic tha: ky prolem nuk është vetem në fshatin Bostan por në të gjitha fshtrat, zyrja jonë e ka pregaditur një projekt se si ta zgjidhim këtë problem dhe jemi afër gjetjes së donatorëve që ta finalizojm projektin, ideja është që Komuna ta jep një pjesë të tokës në mënyrë që të ndertohet një objekt për qenët e pastreh ku do të punësohen edhe dy punëtorë.
Dobrivoje Djordjevic tha: kolega u parqit si avokat i OSBE-së dhe nese ky projekt i juaji nuk realizohet unë do të kërkoj nga ju raport se pse nuk është realizuar pasi që si dhat rast OSBE-së mu deklaru.

Bajrush Ymeri tha: ky problem është në të gjithë Kosovën dhe kohëve të fundit po shoh se ka debate rreth kësaj teme shumë, natyrishtë që një zgjidhje duhet të bëhet edhe tek ne, e përgëzoj Markin për raportin dhe iniciativen e ndërmarrë në rast se do të ketë sukses ky projekt do të jetë i mirëserdhur pasi që të gjithë jemi në rrezik prej qenëve endacak. Pasi që jemi në fund të mbledhjes ju falenderoj shumë për pjesëmarrje dhe po e përgëzoj Kryesuesen për udhëheqjen e mbledhjeve të komitetit.

Pasi nuk pati diskutime tjera kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në 12:15h.

Valmire Mustafa
Procesmbajtese

Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit për Komunitete